



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 56 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, nenin 9.1 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-5017/17, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, Kryetari i Komunës së Podujevës, merr:

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR DIAGNOSTIFIKIM DHE SHËRIM TË FITORE IBISHIT NGA PODUJEVA

Neni 1

znj. Fitore Ibishi nga Podujeva, e cila vuan nga sëmundja e rrallë e ashtuquajtur sindroma Susak, për diagnostifikim dhe shërim, mbështetet me mjete financiare në shumë 1000.00 €.

Mbështetja bëhet përmes turneut humanitar(Ndihmojmë Fitore Ibishin) në futboll të vogël.

Neni 2

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Në pamundësi të kryerjes së shërbimit bankar nga e përmendura për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, mjetet financiare barten në llogarinë e znj. Elfije Ibishit, motra e të përmendurës.

Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Nr. 02-400/04-0046133/17

Podujevë,

27 qershor 2017



Kryetari i Komunës
Agim Veliu